



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Drejtoria e Inspeksionit
Drenas, më 12.03.2019



RAPORT PËR MUAJIN SHKURT 2019

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar inspektime të subjekteve hoteliere rreth respektimit të Ligjit të duhanit si dhe inspektime të Operatorëve Ekonomik në zbatim të urdhërësive nga Ministria e Tregtisë për largimin nga shitja të artikujve që nuk i plotësojnë kriteret për treg, si dhe vendosja e flamurit, origjinës dhe prejardhjes.

SEKTORI I SANITARISË :

Gjatë muajit Shkurt kryesisht janë zhvilluar procedura inspektuese ndaj subjekteve hoteliere për respektim të ligjit të duhanit si dhe furrat rreth kushteve sanitare. Gjithashtu janë dhënë pëlqime ndaj ordinancave dhe barnatoreve. Është mbajtur nën mbikqyrje tregu i kafshëve dhe pemëve duke mos lejuar zhvillim aktiviteteve pa i plotsuar kushtet minimale sanitare. Numri i gjobave në respektimin e ligjit të duhanit :

Gjopa ndaj personave fizik (Ligji i duhanit).....01
-Gjopa ndaj personave përgjegjës (L.duhanit).....06
-Gjopa ndaj p.përgjegjës në furrë(L.Sanitar).....03

SEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë këtij muaji janë mbajtur në kontroll dhe janë zhvilluar procedura për ndërtimet në objektet banesore në Drenas të cilat janë duke u shëndrruar në objekte afariste duke i mbajtur nën vëzhgim në bazë të procedurave. Janë realizuar procedura të kthimit të pronave komunës të cilat janë të uzurpuara. Janë mbikqyrë ndërtimet e reja pa leje ndërtimore ndaj të cilave janë zhvilluar procedurat ligjore. Kompania e rrënit nuk është në dispozicion për shkak të procedurave të prokurimit, pritet gjatë muajit tjetër të lidhet kontratë në mënyrë që të vazhdojmë me procedurat e ekzekutimeve të aktvendimeve për rrënim.

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Në zbatim të Planit Operativ, kanë bërë inspektime rreth transportit të udhëtarëve me rëndësi të veçantë, kontrollë e operatorëve ilegal si dhe rendin e udhëtimit të operatorëve legal, ku gjatë këtij muaji është realizuar plani operativ me Policinë e Kosovës rreth operimit të transportit ilegal.

SEKTORI I TREGUT

Gjatë këtij muaji janë kontrolluar marketet dhe bizneset afariste në bazë të U.A Nr. 20/2018 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të flamurit mbi origjinën e produktit i cili i ka obliguar për vendosjen e flamurit në produkt. Si dhe urdhërësën e Kryeinspektorit të Tregut për produktet e

ekspozuara që nuk përputhen me dokumentacionin përkatës të sekuestrohen. Gjithashtu është angazhuar për përcjelljen e bizneseve tek zyra e regjistrimit të bizneseve në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik për të gjitha bizneset që nuk kanë kryer obligimet financiare si dhe bizneset e pa regjistruara.

SEKTORI I AMBIENTIT

Janë zhvilluar inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palëve, me fokus në inspektimin e bizneseve në relacionin Drenas-Komoran rreth hyrjes së tyre në sistem të menaxhimit të mbeturinave ku gjatë këtij muaji janë urdhëruar që të hyjnë në sistem të menaxhimit të mbeturinave 50 biznese të reja.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin Shkurt 2019:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjoha mandatore	Fletëparaqitje gjykat	Kërkesa për Pëlqim	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit Të dyshimtë
Sanitari	70	03	10(Vlera 1550 €)	-	03	03	03	03	-	-	-
Treg	45	03	3(250€)	-	03	-	03	03	02	-	-
Komunikacion	15	-	10(1100€)	-	-	-	-	-	-	04	-
Ndërtimi	16	03	1(500€)	-	-	-	07	07	-	-	-
Ambient	69	-	1 (100€)	-	-	-	03	03	-	-	-
Totali	215	09	24(3500€)	-	06	03	16	16	02	04	-

Mars, 2019

Drejtoreshë e Drejtorisë

Aurora Berisha